

VENDIM
Nr. 445, datë 22.5.2013

**PËR PËRCAKTIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES PËR DHËNIEN ME KONCESION
VENDOR TË PROJEKTIMIT, NDËRTIMIT, FINANCIMIT, OPERIMIT DHE
TRANSFERIMIT TË TERMINALIT TË TRANSPORTIT PUBLIK NË QYTETIN E TIRANËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pikat 1 e 3, e 16 të ligjit nr. 9663, datë 18.12.2006 “Për koncesionet”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Autoriteti kontraktues për kryerjen e procedurave ligjore për dhënie me koncesion vendor të terminalit të transportit publik në qytetin e Tiranës është Bashkia e Tiranës.
 2. Koncesioni të jetë një koncesion i formës “projektim, ndërtim, financim, operim dhe transferim”, si propozim i kërkuar nga Bashkia e Tiranës.
 3. Ngarkohet Bashkia e Tiranës për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha